

Buletini



DHJETOR 2023





Kryetari Ahmeti pranon pullat postare të qytetit të Lipjanit

Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti ka pritur në takim menaxherin regional të postës së Prishtinës z. Flamur Kadriu me bashkëpunëtorë.

Gjate këtij takimi u bisedua për çështje të ndryshme lidhur me bashkëpunimin në mes të dy institucioneve ku në të njëjtën kohë përfaqësuesit e postës i dhuruan Kryetarit të Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, pullat postare të qytetit të Lipjanit.



Kryetari i Komunës së Lipjanit Imri Ahmeti, ka pritur në zyren e tij nxënësen e klases së dytë Nisa Kallaba nga shkolla fillore “Vëllzërit Frasheri”, në Lipjan e cila u shpall fituese e garave të matematikës në grupmoshën e saj në Dubai.

Kryetari Imri Ahmeti ka ururar nxënësen lipjanase për suksesin dhe gjithë matematicienetet e rinjë të cilët e kanë përfaqësuar Kosovën në garat ndërkombëtare në Dubai.

Në shenjë respekti kryetari Ahmeti i ka dhuruar Nisa Kallaba emblemen e Komunës së Lipjanit dhe mbështetje financiare në vlerë prej 500 eurove.

Në këto gara kanë marrë pjesë rreth 2000 fëmijë nga 45 shtete të botës dhe nxënësja lipjanase Nisa Kallaba është shpallur fituese.



FOTOLAJM/Komuna e Lipjanit ka mbështetur konferencat vjetore DREAMin Kosovo 2023 dhe LEAPin Conference 2023 të cilat kanë për qëllim ngritjen e rolit të institucioneve në zhvillimin dhe fuqizimin e rinisë, ku 12 të rinjë lipjanas morren pjesë në këtë ngjarje të rëndësishme.

Komuna e Lipjanit në vazhdimësi ka përkrahur iniciativa të këtilla, të cilat në fokus kanë zhvillimin e të rinjve si në aspektin profesional, ashtu edhe në atë personal.



Këshilli Komunal për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në Familje dhe në Baza Gjinore në Komunën e Lipjanit, Këshill ky i formuar me vendim të Kryetarit të Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, ka zhvilluar aktivitetet në kuadër të aktivizimit 16-ditor kundër dhunës në baza gjinore.

Këto aktivitete po realizohen me qëllim të ndërgjegjësimit dhe vetëdijesimit të qytetarëve se dhuna ndaj gruas dhe familjes është akt që shkel të drejtat e njeriut. Kjo fushatë do të vazhdoj deri me 10 dhjetor, njëherit do të bëhet edhe promovimi i të drejtës dhe barazisë gjinore.



Mbahet festivali mbarëkombëtar i këngës për fëmijë, “Lipjani Këndon”

Në sallën e sporteve “Better Life” në Lipjan, për herë të IV është mbajtur festivali mbarëkombëtar i këngës për fëmijë, “Lipjani Këndon”.

Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti ka potencuar se ky festival është një mundësi e mirë që gjeneratat e reja të shpalosin talentet e tyre në këndim.

“Është ndjenjë e veçantë të shikosh talentin e fëmijëve në përformimin e tyre në këndim kjo neve na bën që të vazhdojmë të investojmë edhe më shumë në organizime të tilla e të cilat kanë karakter garues por edhe promovues të këtyre talentëve e të cilët Lipjani i ka të shumtë” ka thënë kryetari Ahmeti.



Filluan punimet për ndërtimin e objektit të Qendrës Urgjente dhe Qendres Kryesore të Mjekësisë Familjare në Komunën e Lipjanit

Kryetari i Komunës së Lipjanit Imri Ahmeti i shoqëruar me bashkëpunëtorët e tij, menaxhmentin e QKMF-së dhe mjekët, kanë vënë gurthemelin e objektit të ri të Qendrës Urgjente dhe QKMF-së në Lipjan.

“Jemi këtu për të vendosur gurëthemelin e njërit prej objekteve më të rëndësishme të shëndetësisë primare në Lipjan, është një prej projekteve më madhore për qytetin tonë dhe për komunën tonë sepse kemi objekte shëndetësore të vjetra të trashëguara të paraluftës. Urojmë dhe shpresojmë që me përfundimin e këtij projekti që është një prej qendrave shëndetësore më të mëdha dhe më moderne në Kosovë, t’i shërbejmë në formën më të mirë pacientëve”, është shprehur Kryetari Ahmeti.

Ky projekt është investim nga buxheti i Komunës së Lipjanit dhe kap vlerën 1.8 milion euro.



Komuna e Lipjanit ka ndezur dritat e pemës së Vitit të Ri dhe dritat dekorative për festat e fund vitit

Kryetari i Komunës së Lipjani z. Imri Ahmeti ka ndezur dritat për festat e fund vitit në sheshin Adem Jashari.

Kryetari z. Imri Ahmeti ka thënë se me afrimin e fundit të vitit, ne kemi stolisur qytetin tonë të dashur me drita dekoruese, duke e shëndërruar atë në një vend mahnitës.

“Dekorimi na sjell ngjyra, ngrohtësi e mbi te gjitha dashuri e shpresë dhe na mbush me gëzim dhe pritje. Duke uruar qytetarët për festat e fund vitit dua të falënderoj e të shpreh mirënjohje të lartë për bashkëpunimin dhe kontributin gjatë vitit duke ndërtuar kështu çdo ditë e më shumë qytetin tonë”

Kryetari Ahmeti ka uruar qe festat e fund vitit të na gjejnë, shëndetplotë me gjithë familjen me dashuri dhe respekt mes nesh.



Kryetari i Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti, ka marrë pjesë në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit ndër komunal të regjionit të Prishtinës.

Përmes kësaj marrëveshjeje ndërkomunale Komuna e Lipjanit dhe komunat e tjera pjesëmarrëse si: Prishtina, Obiliqi, Fushë-Kosova, Podujeva e Graçanica do të bashkërendojnë aktivitetet në fushat e menaxhimit të mbeturinave, qenëve endacakë dhe transportit publik, me anë të cilave do të krijohen lehtësira për mirëqenien e qytetarëve të këtyre komunave.

”Në kuadër të kësaj marrëveshjeje që nënshkruam sot përfshinë edhe krijimin e një linje funksionale të transportit urban në relacionin Prishtinë–Lipjan–Janjevë si dhe plane të tjera të përbashkëta që ndërlidhen me trafikun dhe çështje të tjera të përbashkëta” tha ndër të tjera Kryetari Ahmeti.

Kjo marrëveshjeje ndërkomunale është nënshkruar nga Kryetari i Lipjanit, z. Imri Ahmeti dhe kryetarët e komunave Prishtinë, Obiliqi, Podujevë, Graçanicë dhe Fushë Kosovë.



Në sallën e Kuvendit të Komunës së Lipjanit gjatë ditës është mbajtur debat i hapur publik për të diskutuar Draft- Planin e punës të ekipit për të drejtat e fëmijës (2024-2026).

Me këtë rast, Drejtori për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, z. Shkelzen Hajdini, Tha se Komuna e Lipjanit promovon të drejtat dhe mirëqenien e çdo fëmije. Investimi në fëmijët tanë ka një rëndësi vendimtare për të ardhmen e Kosovës. Fëmijët e sotëm 10 vjeçar janë fuqia punëtore e vitit 2030, që do të thotë se kujdesi për të gjithë fëmijët sot është investimi vendimtar për të ardhmen e Kosovës dhe për të siguruar një mjedis konkurrues për shtetin e Kosovës.

Në fund të këtij takimi drejtori Shkelzen Hajdini, ka kërkuar nga qytetarët lipjanas që të jenë sa më aktive gjatë fazës së konsultimit publik të këtij Plani në mënyrë të kemi një dokument sa më gjithëpërfshirës.

Të pranishmit patën rastin të diskutojnë lidhur shumë çështje lidhur me këtë Plan.



Nënkryetari i Komunës z. Diamant Bytyqi së bashku me nënkryetarin për komunitete z. Lulzim Qerimi dhe me bashkëpunëtorë ka pritur në takim U.d shefin e zyrës së Këshillit të Europes, zyra në Prishtinë, z. Tankut Soykan, përfaqësuesit e programit Romacted znj. Sakibe Jashari dhe z. Besim Shkololli dhe përfaqësues të organizatës “All youth together”.

Nënkryetari z. Diamant Bytyqi tha se është mirënjohës që Komuna e Lipjanit ka qenë pjesë e këtij programi dhe se kanë qenë të përpiktë në gjithë angazhimin e përbashkët me përfaqësuesit e Romacted. “Falenderoj Këshillin e Evropës, zyrën në Prishtinë për përfshirjen e komunës sonë në Programin Romacted. Besoj që projekte të tilla do të inaugurojmë edhe në të ardhmen dhe bashkëpunimi ynë të vazhdoj edhe me projekte të tjera”, është shprehur nënkryetari Bytyqi.

“Ne do të vazhdojmë të përkrahim të drejtat e njeriut dhe të komuniteteve në Komunën e Lipjanit. Dua të theksoj se dyert tona janë të hapura gjithmonë për ju si institucion dhe për komunitetet që jetojnë në komunën tuaj” është shprehur z. Soykan.



Homazhe nderimi për katër dëshmorët në fshatin Krojmir

Në nderim të 25 vjetorit të rënies së katër dëshmorëve të fshatit Krojmir nënkryetari Diamant Bytyqi i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, kanë bërë homazhe dhe ka vënë kurorë lulesh pranë pllakës përkujtimore dhe kompleksit memorial “Katër dëshmorët”, në fshatin Krojmir.



Komiteti për Komunitete ka mbajtur mbledhjen e 21-të, të cilën e kryesoi Skender Bikliqi dhe u shqyrtuan pikat të cilat ishin të propozuara për rend të ditës së kësaj mbledhje.

Gjatë kësaj mbledhje u shqyrtua dhe u aprovua Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024 dhe janë diskutuar shumë çështje të tjera lidhur të cilat kanë bëjnë me qytetarët e komunitetit jo shumicë që jeton në Komunën e Lipjanit.



Në shkollën fillore të Mesme të Ulët “Haredin Bajrami”, në Magure gjatë ditës në prani të nënkryetarit të komunës z. Diamant Bytyqi, drejtorit për Buxhet dhe Financa z. Latif Ramadani, është pranuar një donacion me pajisje kompjuterike nga Qeveria Romune nga programi RoAid.

Nënkryetari z. Diamant Bytyqi ka falënderuar qeverinë Romune dhe programin RoAid për donacionin, duke thënë se pajisje të tilla janë të nevojshme për zhvillimin e mëtutjeshëm të procesit arsimor në Lipjan.

Ky donacion përfshijnë këto pajisje: 10 desktop, 10 projektor dhe pajisje tjera përcjellëse.



Në sallën e takimeve, Kryetari i Komunës, z.Imri Ahmeti së bashku me Drejtorin e DKA-së z. Rasim Hasani, kanë takuar drejtorët e shkollave me të cilët kanë diskutuar lidhur me mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor në Komunën e Lipjanit.

Kryetari z. Imri Ahmeti, fillimisht ka falenderuar drejtorët e të gjitha shkollave në komunën tonë për angazhimin e tyre në menaxhimin e shkollave gjatë vitit që po e lëmë pas. Njëherit ai ka kërkuar nga të gjithë të pranishmit që edhe më tutje të angazhohen për një rend e rregull në të gjitha shkollat si dhe për një proces mësimor sa më cilësor.



Kryetari i Komunës së Lipjanit z.Imri Ahmeti, me bashkëpunëtorët e tij, me rastin e 23-vjetorit të ndarjes nga jeta të Komandantit të UÇK-së Lulzim Morina (Komandant Luli), nga Brigada “135 Agim Zeneli”, në nderim të jetës dhe veprës së tij kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur kurorë lulesh pranë lapidarit të tij në fshatin Hallaq i Vogël.




KPF ka mbajtur mbledhjen e 22-të me radhë

Nën udhëheqjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, z. Daut Azemi në sallën e takimeve në Komunën e Lipjanit, është mbajtur mbledhja e 22-të dhe e fundit për vitin 2023 e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), në të cilën u prezantuan dhe u diskutuan të gjitha pikat e rendit të ditës.

Me këtë rast, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, z. Daut Azemi, përveç pikave të parapara për këtë mbledhje, me propozim nga ekzekutivi ka propozuar edhe një pikë shtesë për rendin e ditës.

Anëtarët e KPF-së pas diskutimeve që paten, kanë rekomanduar të gjitha pikat e rendit të ditës për mbledhjen e 25-të të Kuvendit të Komunës që mbahet më 21 dhjetor 2023, duke filluar nga ora 10:00 në sallën e Kuvendit Komunal.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka njoftuar se mbetet në fuqi vendimi për ndalimin e ndezjes së fishekzjarrëve dhe mjeteve piroteknike gjatë festave të fund vitit, në hapësirat publike të Komunës së Lipjanit si dhe në zonat e banuara përveq në hapësirën e tregut të gjelbër që gjendet në rr. “Xhavit Kozhani”, në Lipjan.

Ndalimi i ndezjes së fishekzjarrëve dhe mjeteve piroteknike bëhet më qëllim të sigurisë së qytetarëve, mbrojtjes së ajrit dhe mjedisit në mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve.



Mbahet mbledhja e 25-të e Kuvendit të Komunës së Lipjanit

Udhëhequr nga Kryesuesi, z. Daut Azemi, Kuvendi i Komunës së Lipjanit, ka zhvilluar punimet e mbledhjes së 25-të dhe të fundit për vitin 2023, në të cilën me shumicë votash u aprovuan të gjitha pikat e rendit të ditës dhe dy pika tjera shtesë të propozuara nga ekzekutivi.

Me vazhdimin e punimeve të kësaj mbledhje, Kryetari z. Imri Ahmeti dhe drejtorët e Drejtorive kanë dhënë sqarime rreth çështjeve të ndryshme që kanë ngritur anëtarët e Kuvendit të Komunës.



Komuna e Lipjanit, përkatësisht Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport në bibliotekën e qytetit ka organizuar ceremoninë e ndarjes së çmimeve për sportistin e vitit, trajnerin e vitit si dhe lexuesin e vitit 2023

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka uruar fituesit për çmimet e sotme dhe theksoi rëndësinë e këtij aktiviteti si një formë falenderimi dhe vlerësimi për përpjekjet dhe rezultatet e shkëlqyera të sportistëve gjatë vitit që po e lëmë pas.

Për ndarjen e këtyre çmimeve vjetore Komuna e Lipjanit paraprakisht ka shpallur ftesë publike për dërgimin e propozimeve dhe pastaj komisioni vlerësues ka bërë përzgjedhjen e tyre nga propozimet e pranuar.

Fituesit e çmimeve janë:

Astrit Shala – Trajneri i vititi 2023

Labinot Ibrahimimi – Sportisti i vititi 2023

Liberta Shala – Lexuesja e vitit 2023



Kryetari Ahmeti ka mbajtur takim publik me qytetarë

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti në sallën e Kuvendit Komunal në përmbyllje të vitit 2023, ka mbajtur mbledhjen publike me qytetarë, të cilët i ka njoftuar për punët e realizuara, sfidat dhe të arriturat e komunës përgjatë këtij viti.

Kryetari Ahmeti, është shprehur i kënaqur me realizimin e të hyrave vetanake gjatë këtij viti si dhe me investimet e realizuara gjatë kësaj periudhe, investime këto të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejtë në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Komunës së Lipjanit. Ai e ka quajtur vitin 2023 si të suksesshëm, duke ja atribuar këtë sukses qytetarëve të Lipjanit.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmet ka organizuar ceremoninë solemne, tashmë tradicionale në përmbyllje të vitit 2023

Në këtë ceremoni, Kryetari Ahmeti ka falënderuar të gjithë përfaqësuesit e organizatave vendore e ndërkombëtare si dhe investitorët e tjerë të cilët kanë mbështetur Komunën e Lipjani në realizimin e projekteve të ndryshme gjatë gjithë këtij viti.

Kryetari Ahmeti, nga ky organizim ka uruar të gjithë qytetarët festat e fund vitit, si dhe i ka ftuar që të vazhdojnë të jenë bashkëpunues në zhvillimin e qytetit dhe vendbanimeve tona.

Në fund të kësaj ceremonie përmes një reportazhi të përgatitur nga Sektori për Marrëdhënie me Publikun, është shfaqur një përmbledhje e shkurtër e punëve dhe aktiviteteve të realizuara nga Komuna e Lipjanit gjatë vitit 2023.



Në prag të festave të fund vitit disa nxënës nga klasa e dytë e shkollës fillore të mesme të ulët “Hajredin Bajrami” në Qylagë kanë takuar Kryetarin e Komunës së Lipjanit z. Imri Ahmeti të cilit i dhuruan projektin e punuar nga fëmijët të titulluar “Sheshi i qytetit në sytë tanë”.

Kryetari z. Imri Ahmeti uroj fëmijët për projektin e dizajnit të sheshit të qytetit të Lipjanit një projekt i veçantë pasi që është punuar nga vetë fëmijët të cilët kanë treguar frymëzim për punë e për përkushtim, njëherit ai u ka uruar këtyre fëmijëve shëndete e shumë suksese në edukimin dhe shkollimin.

Nga ana tjetër ky grup i fëmijëve ka recituar disa poezi të dedikuara kryetarit të komunës z. Imri Ahmeti për respektin ndaj tij. Në fund të takimit kryetari Ahmeti uroj fëmijët për festat e fund vitit dhe ndau disa dhurata për ta.




Të dashur qytetarë,

Në këtë natë të ndërrimit të viteve, falënderojmë të gjithë qytetarët e Lipjanit për mbështetjen e vazhdueshme në sfidat dhe arritjet e përbashkëta. Urojmë të festojmë në harmoni dhe lumturi të plotë në familje dhe shoqëri.

Paçi një vit të mbarë përpara me plotë shpresë, besim dhe suksese në synimet tona të përbashkëta.

***Shëndet e mbarësi për të gjithë!
Gëzuar 2024!***

Komuna e Lipjanit - Zyra për informim



0 800 14 000 / 038 200 41 508



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



Rr. Shqipëria nr: 28 14000 Lipjan, Kosovë